



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË , USHQIMIT DHE ^{up}
MBROJTES SË KONSUMATORIT
DPPB

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 2, Tiranë, Tel - Fax (04) 222 86 21, www.mbu.gov.al

Nr 903 Prot.

Tiranë, më 4.03 2009

RREGULLORE

Nr 4 datë 4.03 2009

MBI

**“STANDARDET PËR MBARËSHTIMIN E DERRAVE E PULAVE
PJELLËSE”**

Në mbështetje të nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të neneve nr. 4, dhe 17 të ligjit nr 9426 dt. 6. 10. 2005, “Për Mbarështimin e Blegtorisë” i ndryshuar, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nxjerr këtë rregullore:

Kreu I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton standardet minimale për mirëqenien e derrave të destinuar për mbarë dhe majmëri, si dhe për mirëqenien e pulave pjellëse dhe nuk zbatohet në:

- stabilimentet me më pak se 350 pula pjellëse.
- stabilimente që mbarështojnë pula pjellëse të racës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË , USHQIMIT DHE ^{up}
MBROJTES SË KONSUMATORIT
DPPB

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 2, Tiranë, Tel - Fax (04) 222 86 21, www.mbu.gov.al

Nr 903 Prot.

Tiranë, më 4.03 2009

RREGULLORE

Nr 1 datë 4.03 2009

MBI

**“STANDARDET PËR MBARËSHTIMIN E DERRAVE E PULAVE
PJELLËSE”**

Në mbështetje të nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të neneve nr. 4, dhe 17 të ligjit nr 9426 dt. 6. 10. 2005, “Për Mbarështimin e Blegtorisë” i ndryshuar, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nxjerr këtë rregullore:

Kreu I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton standardet minimale për mirëqenien e derrave të destinuar për mbarë dhe majmëri, si dhe për mirëqenien e pulave pjellëse dhe nuk zbatohet në:

- stabilimentet me më pak se 350 pula pjellëse.
- stabilimente që mbarështojnë pula pjellëse të racës.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Derr”: është një kafshë e species së derrit , e çdo moshe, e mbajtur për mbarë ose majmëri.
2. “Harç”: është një derr mashkull pas pubertetit, i mbajtur për mbarë.
3. “Paradosë”: është një derr femër pas pubertetit dhe përpara pjelljes së parë.
- 4 “Dosë” : është një derr femër pas pjelljes parë
- 5 “Dosa me gica”: është një derr femër ndërmjet periudhës së pas pjelljes deri në këputje të gicave.
6. “Dosa barrëse”: është një dosë ndërmjet periudhës së këputjes së gicave dhe pjelljes.
7. “Gic”: është një derr nga lindja deri në këputje nga gjiri.
8. “Derr i këputur” : është një derr nga këputja deri në moshën 10 javë.
9. “Derr në rritje”: është një derr nga mosha 10 javësh deri në therje ose ndërzim.
10. “Pula pjellëse”: Janë pula që kanë arritur pjekurinë për të prodhuar vezë dhe mbahen për prodhim vezësh jo për çelje por për konsum.
11. “Furrik” është një hapësirë e veçuar (e ndarë) ku pulat pjellin vezët dyshemeja e të cilit nuk duhet të përfshijë rrjetën e telit që mund të bjerë në kontakt me pulat si për një pulë të vetme ashtu edhe për grup pulash (furrik i përbërë për disa pula).
12. “Shtresë” është material i shkruar ku pulat plotësojnë nevojat e sjelljes së tyre (etologjike).
13. “hapësirë e përdorshme” është një hapësirë së paku 30 cm e gjerë me pjerrësi dyshemeje jo më shumë se 14 % dhe lartësi të brendshme së paku 45 cm. Këtu nuk përfshihet zona që zë furriku.

Kreu II

Kërkesa për mirëqenien e derrave

Neni 3

Kërkesat për strehim

1 Të gjitha strehimet e derrave duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- (a) Sipërfaqja e lirë e dyshemesë në dispozicion për çdo gic të këputur ose derr në rritje i mbajtur në grup, duke përjashtuar paradosat pas ndërimit dhe dosat duhet të jetë të paktën:

Pesha e gjallë në kg	Metër katror
Deri në 10	0.15
Nga 10-20	0.20
Nga 20-30	0.30
Nga 30-50	0.40
Nga 50-85	0.55
Nga 85-110	0.65
Më tepër se 110	1.00

- (b) Sipërfaqja totale e lirë e dyshemesë për çdo paradosë pas fekondimit dhe për çdo dosë kur paradosat dhe/ose dosat mbahen në grupe duhet të jenë të paktën 1,64m² dhe 2,25 m² respektivisht.

Kur këto kafshë mbahen në grupe me më pak se 6 individë, sipërfaqja e dyshemesë duhet të rritet me 10%. Kur këto kafshë mbahen në grupe me 40 ose më shumë individë sipërfaqja e lirë e dyshemesë mund të zvogëlohet me 10 %

2. Sipërfaqja e dyshemesë duhet të jetë sipas kërkesave të mëposhtme:

- (a) Për paradosat pas fekondimit dhe dosat barrse:

Për paradosat një pjesë e sipërfaqes së nevojshme të përcaktuar sipas pikës 1 (b) të këtij neni, e barabartë me të paktën 0.95 m² dhe për dosat të paktën 1,3 m² duhet të jetë me dysheme solide nga e cila një minimum prej 15 % rezervohet për kanalet e urinës.

- (b) Kur derrat mbahen në grupe në dysheme të tipit zgarë atëherë:

- (i) gjerësia maksimale e çarjeve duhet të jetë:

- 11 mm për gicat
- 14 mm për gicat e këputur
- 18 mm për derrat në rritje
- 20 mm për paradosat pas fekondimit dhe dosat

- (ii) Gjerësia minimale e çarjeve duhet të jetë:

- 50 mm për gicat në mëmëzim dhe ato të këputur

- 80 mm për derrat në rritje, paradosat pas fekondimit dhe dosat.

3. Ndërtimet në të cilën paradosat ose dosat mbahen të lidhura si dhe përdorimi i lidhëseve ndalohet.

4. (a) Dosat dhe paradosat duhet të mbahen në grupe gjatë një periudhe që fillon nga 4 javë pas fekondimit deri një javë përpara kohës së pjelljes së pritshme. Boksi ku mbahet grupi, anësoret duhet të kenë një gjatësi mbi 2.8 m. Kur grupi ka më pak se 6 krerë, anësoret duhet të kenë një gjatësi mbi 2.4 m.

(b) Në rastin e mos zbatimit të germës (a) të pikës 4 të këtij neni dosat dhe paradosat e mbajtura në strehime me më pak se 10 krerë mund të mbahen individualisht gjatë periudhës së përmendur në germën (a) të pikës 4 të këtij neni, me kusht që ato të mund të lëvizin rreth e përqark me lehtësi në bokset e tyre.

Kushtet e vendosura në germën (a) të pikës 4 të këtij neni, nuk duhen të zbatohen për strehimet me më pak se 10 dosa.

Neni 4

Kushtet për një të ushqyer të përshtatshëm

1. Dosat dhe gicat të mbajtur në grupe përveç kushteve të përcaktuara në kreun e dytë duhet të ushqehen duke përdorur një sistem i cili siguron që çdo individ mund të marrë ushqim të mjaftueshëm edhe kur konkurrenca për ushqim është e pranishme.

2. Për të plotësuar nevojat e tyre për ushqim, dhe mundësinë e të përtypurit, të gjithë dosave dhe paradosave barrse duhet ti jepet një sasi e mjaftueshme e ushqimit voluminoz ose me përmbajtje të lartë të celulozës si dhe ushqim me densitet energjetik të lartë.

3. Derrat të cilët dallohen për agresivitet dhe ato që janë sulmuar nga derra të tjerë ose që janë të sëmurë, të dëmtuar, mund të mbahen përkohësisht në bokse individuale. Në këtë rast bokset individuale duhet ta lejojnë kafshën që të rrotullohet lehtësisht, në qoftë se kjo nuk bie ndesh me rekomandimet e veçanta të mjekut veterinar.

Neni 5

Trajnimi i rritësve

1. Çdo person i cili punëson ose angazhon persona të tjerë për tu kujdesur për derrat siguron që ai të ketë marrë më parë instruksionet dhe udhëzimet të përcaktuara në kreun dy dhe tre të kësaj rregulloreje
2. Duhet të bëhen kurse trajnimi, të cilat duhet të fokusohen veçanërisht në aspektet e mirëqenies.

KREU III

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 6

Kushtet teknologjike për rritje

Përveç kërkesave të mësipërme duhet të zbatohen edhe kërkesat e mëposhtme:

1. Në ndërtesat ku mbahen derrat niveli i zhurmës së vazhdueshme nuk duhet të kalojë 85 dBA (decibel). Zhurmat e papritura dhe ato të vazhdueshme mbi këtë nivel duhet të evitohen.
2. Derrat duhet të mbahen në një ndriçim me intensitet jo më pak se 40 Luks, për një periudhë kohe minimale prej 8 orë/ditë.
3. Strehimi për derrat duhet të ndërtohet në një mënyrë të tillë që ti lejojë kafshët që:
 - a. Kafsha të rri shtrirë në mënyrë të rehatshme me temperaturë të përshtatshme, e pastruar dhe e kulluar mirë dhe ti lejojë ato që të qëndrojnë shtrirë në të njëjtën kohë dhe të shohin njëra tjetrën.
 - b. Të pushojnë dhe të ngrihen normalisht.
 - c. Në javën përpara pjelljes, si dhe kohën e pritshme të pjelljes dhe gjatë saj, dosat dhe paradosat mund të mbahen jashtë të parit të njeri-tjetrit gjatë këtyre proceseve fiziologjike.
4. Derrave duhet tu sigurohet një sasi e mjaftueshme materialesh për të plotësuar sjelljet e tyre, të tillë si kashta, bari, dru, tallash, pleh i krijuar nga dekompozimi i bimëve ose një përzierje e tillë, e cila nuk dëmton shëndetin e kafshëve.
5. Dyshemeja duhet të jetë e lëmuar por jo e rrëshqitshme, me qëllim që

të parandalojë dëmtimet e derrave dhe e projektuar, ndërtuar dhe mirëmbajtur në mënyrë të tillë që të mos shkaktojë dëmtim apo vuajtje të derrave. Ato duhet të jenë të përshtatshme sipas madhësisë dhe peshës së derrave dhe n.q.s nuk sigurohet shtresë, formohet një sipërfaqe e papërkulshme dhe e lëmuar.

6. Të gjithë derrat duhet të ushqehen të paktën një herë në ditë. Kur derrat ushqehen në grupe dhe jo sipas dëshirës ose nëpërmjet një sistemi automatik të të ushqyerit çdo derr duhet të ketë të drejtën për marrjen e ushqimit në të njëjtën kohë si të tjerët në grup.
7. Të gjithë derrave të moshës mbi 2 javë duhet tu sigurohet një sasi të mjaftueshme uji të freskët.

Neni 7

Procedura të tjera jo terapeutike dhe diagnostike për mbarështimin e derrave

1. Të gjithë procedurat dhe ndërhyrjet jo për qëllime mjekuese ose diagnostike apo për identifikimin e derrave, që dëmtojnë apo shkaktojnë humbjen e ndjeshmërisë së pjesës së ndjeshme të trupit të derrave si dhe dëmtim të strukturës kockore janë të ndaluara me përjashtim të:
 - a. Shkurtimit të dhëmbëve të qenit të gicave nëpërmjet prerjes jo më vonë se në moshën 7 ditëshe, ku dhëmbët në pjesën e sipërme duhet të kenë një sipërfaqe të sheshtë; tek harçat këto dhëmbë mund të zvogëlohen në gjatësi kur është e nevojshme për të parandaluar dëmtimet në kafshët e tjera ose për arsye sigurie.
 - b. Prerja e një pjesë të bishtit.
 - c. Kastrimi i gicave meshkuj me mjete të tjera ose nëpërmjet tredhjes
 - d. Izolimi i noçkës por vetëm kur kafshët mbahen në sistemin e mbajtjes jashtë.
2. Shkurtimi i bishtit si dhe shkurtimi i dhëmbëve të qenit nuk duhet të kryhet në mënyrë rutinë por vetëm kur ka të dhëna që dëmtohen thithat e dosës ose të veshëve dhe bishtit. Përpara kryerjes së këtyre procedurave, duhet të ndërmerren masa të tjera për të penguar kafshimin e bishtit dhe zakone të tjera duke marrë parasysh ambientin dhe dendësinë e kafshëve. Për këtë arsye duhet të ndryshohen kushtet e mjedisit dhe sistemet e mbarështimit të pa përshtatshme.
3. Çdo procedurë e përshkruar më sipër duhet të kryhet vetëm nga veterineri ose një person i trajnuar siç jepet në Nenin 5 të kësaj rregulloreje, në

kryerjen e teknikave të zbatuara me mjete të përshtatshme dhe në kushte higjienike. Në qoftë se kastrimi ose prerja e bishtit praktikohet pas moshës një javëshe, kjo duhet të kryhet vetëm në kushte anestezie nga një veteriner.

KREU IV

KUSHTE TË VEÇANTA PËR KATEGORI TË NDRYSHME DERRASH

Neni 8

Harçat

Për harçat:

1. Boksi duhet të jetë i ndërtuar në mënyre të tillë që të lejojë harçin që të rrotullohet lirisht, të dëgjojë, nuhasë dhe të shikojë derrat e tjerë.
2. Sipërfaqja e dyshemesë duhet të jetë të paktën 6 m² dhe e sheshtë
3. Në bokset që përdoren për ndërzim natyral, sipërfaqja e dyshemesë për një harç me moshë të rritur duhet të jetë të paktën 10 m² dhe e sheshtë .

Neni 9

Dosat dhe paradosat

Për dosat dhe paradosat:

1. Të merren masa për të minimizuar agresionin në grupe.
2. Dosat dhe paradosat barrse në qoftë se është e nevojshme duhet të trajtohen kundër parazitëve të brendshëm dhe të jashtëm . Në qoftë se ato vendosen në bokset e pjelljes, dosat dhe paradosat barrse duhet të pastrohen plotësisht.
3. Një javë para pjelljes dosat dhe paradosat duhet të kenë material të përshtatshëm në sasi të mjaftueshme për formimin e çerdhes me përjashtim kur teknikisht nuk është e këshillueshme për sistemet të mbajtjes në baltë.
4. Dosat të pjellin në hapësira të mjaftueshme në një dysheme të lëmuar për të lehtësuar pjelljen normale ose me ndërhyrje
5. Materniteti ku dosat mbahen të lira duhet të kenë disa mjete të mbrojtjes ndarëse të boksit për mbrojtjen e gicave.

Neni 10

Gicat e porsalindur

Për gicat e porsalindur:

1. Një pjesë e dyshemesë, e mjaftueshme për të lejuar kafshët për të pushuar së bashku në të njëjtën kohë duhet të jetë solide ose e mbuluar me një shtresë prej kashte ose ndonjë materiali tjetër të përshtatshëm
2. Gicat duhet të kenë sipërfaqe të mjaftueshme për të pirë tek dosa pa vështirësi.
3. Asnjë gic nuk duhet të këputet nga dosa me moshë nën 28 ditë, sepse dëmtohet shëndeti i nënës (dosës) dhe i gicave. Megjithatë, gicat mund të këputen edhe një javë më parë në qoftë se ato zhvendosen në strehime të specializuara të cilat janë bosh dhe të pastruar, dezinfektuar plotësisht përpara futjes së një grupi të ri të cilët janë të veçuar nga strehimet ku dosat mbahen, me qëllim për të minimizuar transmetimin e sëmundjeve për gicat.

Neni 11

Gicat e këputur dhe në rritje

1. Kur gicat mbahen në grupe duhet të merren masa për të penguar grindjen midis tyre e cila i kalon sjelljet normale.
2. Ato duhet të mbahen në grupe ku përzierja të jetë sa më e vogël. Në qoftë se gicat nuk janë mësuar me njeri tjetrin duhet të bashkohen kjo duhet të bëhet në një moshë sa me të hershme të jetë e mundur, preferohet një jave para ose pas këputjes. Kur gicat bashkohen atyre duhet t'ju sigurohen mundësi të mjaftueshme për t'ju shmangur dhe fshehur gicave të tjerë.
3. Kur vërehen shenja të grindjeve të rënda ndërmjet gicave duhet menjëherë të përcaktohen shkaqet dhe të merren masa të përshtatshme të tilla, si sigurimi i kashtës së bollshme për kafshët ose materiale të tjera për investigim. Kafshët që rrezikohen ose ato që janë agresive duhet të mbahen të veçuara nga grupi.
4. Përdorimi i medikamenteve qetësuese me qëllim për lehtësuar bashkimin duhet të jetë i kufizuar shumë dhe të përdoren në raste të veçanta dhe vetëm pas konsultimit me mjekun.

KREU V

STANDARTET MINIMALE PËR MBARËSHTIMIN E PULAVE PJELLËSE.

Neni 12

Kushtet të zbatueshme për sistemet alternative

Autoriteti Kompetent duhet të sigurojë që të gjithë sistemet e reja apo të rindërtuara të prodhimit për të cilat bëhet fjalë në këtë kapitull dhe të gjitha sistemet e tilla që futen në prodhim për herë të parë të jenë në përputhje të paktën me kërkesat e mëposhtme:

1. Të gjitha sistemet duhet të pajisen në mënyrë të tillë që të gjitha pulat pjellëse të kenë:

(a) Lugje lineare ushqimi ku çdo pulë të ketë së paku 10 cm ose lugje rrethore me së paku 4 cm për çdo pulë.

(b) Pirëset me ujë të jenë të vazhdueshme me 2.5 cm hapësirë pirëse për çdo pulë ose rrethore për t'u siguruar 1 cm hapësirë për pulë.

Kur përdoren kupa pirëse këto duhet të jenë 1 për 10 pula pjellëse.

Kur pikat pirëse janë sisteme hidraulike të ketë dy kupa pirëse të arritshme nga çdo pulë pjellëse.

(c) Për çdo grup prej 7 pulash pjellëse, të ketë së paku 1 furrik. Kur përdoren furriqe në grupe duhet të ketë të paktën 1 m katror hapësirë furriqesh për maksimumi 120 pula pjellëse.

(d) Për çdo pulë të ketë 15 cm tel ku qëndron pula. Telat nuk montohen mbi shtresë. Distanca horizontale ndërmjet këtyre telave duhet të jetë të paktën 30 cm ndërsa distanca horizontale ndërmjet telit dhe murit të jetë 20 cm.

(e) Për çdo pulë të ketë së paku 250 cm katror hapësirë për shtresë që zë 1/3 e sipërfaqes së dyshemesë.

2. Instalimet e dyshemeve duhet të jenë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të mbështetet çdo thua i përparmë i çdo këmbë.

Neni 13

Kushte të tjera të zbatueshme për sistemet alternative

1. Përveç përcaktimeve të përshkruara në pikat 1 dhe 2 të nenit 12 të kësaj rregullore në qoftë se përdoren sistemet e mbarështimit ku pulat pjellëse mund të lëvizin lirisht ndërmjet niveleve të ndryshme, duhet të sigurohet që:

(a) Nuk duhet të ketë më tepër se 4 nivele.

(b) Lartësia ndërmjet niveleve duhet të jetë të paktën 45 cm.

(c) Pajisjet e pirjes së ujit dhe të ushqyerit duhet të shpërndahen në mënyrë të tillë që të sigurojnë mundësi të barabartë për të gjitha pulat.

(d) Nivelet duhet të rregullohen në mënyrë të tillë që të parandalohen rënia e glaseve (rrjedhjeve) në nivelet më poshtë.

2. Kur pulat pjellëse mbahen në linja të hapura:

(a) Duhet të kenë disa dalje të cilat japin mundësi për të dalë jashtë, të paktën të jenë 35 cm të larta, 40 cm të gjëra dhe të shtrihen përgjatë gjithë gjatësisë së ndërtesës, në çdo rast të jetë një hapje totale 2 m për një grup prej 1000 pulash.

(b) Hapsirat e hapura duhet të jenë:

i - në një zonë të përshtatshme për densitetin e përqendrimit dhe për natyrën e dyshemesë që të parandalohen kontaminimet.

ii - të jenë të pajisura me shtresë për të fjetur rehat natën.

3. Densiteti i përgjithshëm i pulave nuk duhet të kalojë 9 pula pjellëse për metër katror hapësirë të përdorshme.

Megjithatë, kur zona e përdorshme korrespondon me sipërfaqen e nevojshme Autoriteti Kompetent autorizon një densitet përqendrimi prej 12 pulash pjellëse për metër katror.

KERU VI

Kushte të zbatueshme për mbarështimin e pulave në kafaz në sistemet jo moderne

Neni 14

Kushte për rritje

Sistemet e rritjes në kafaz duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Për çdo pulë të sigurohet një hapësirë (zona kafazit) të paktën 550 cm katror që mund të përdoret pa kufizim.

2. Gjatësia e lugut të ushqimit të jetë së paku 10 cm shumëzuar me numrin e pulave pjellëse në kafaz në mënyrë që të mund të përdoret pa kufizim.

3. Çdo kafaz duhet të ketë kanal për pirje uji të vazhdueshëm në të njëjtën gjatësi me lugun e ushqimit të përmendur në pikën 2 të këtij neni. Kur vendet e pirjes janë të fiksuara, të ketë dy pika pirjeje ose dy gota për kafaz.

4. Kafazet duhet të jenë së paku 40 cm të larta në rreth 65 % të sipërfaqes së kafazit dhe jo më pak se 35 cm nga çdo pikë.

5. Dyshemetë e kafazeve duhet të jenë të ndërtuara që të mbështeten siç duhet gishtat me thonjtë e pulave. Pjerrësia e dyshemesë nuk duhet të kalojë 14% ose 8%. Në rast se kemi të bëjmë me dysheme me rrjetë teli jo me katrore, Autoriteti Kompetent mund të lejojë pjerrësi më të madhe.

6. Kafazët duhet të përshtaten me ndarje që përdoret për shkurtimin e thonjve.

KAPITULLI VII

Kushte të zbatueshme për mbarështimin e pulave në kafaz në sistemet moderne

Neni 15

Kushte për rritje

Autoriteti Kompetent duhet të sigurojë që të gjithë kafazet duhet të plotësojnë së paku këto kërkesa:

1. Pulat pjellëse duhet të kenë:

(a) Të paktën 750 cm katror hapësirë në kafaz për pulë, 600 cm katror e së cilës duhet të jetë e përdorshme, lartësia e kafazit duhet të jetë të paktën 20 cm në çdo pikë dhe asnjë kafaz nuk duhet të ketë sipërfaqe totale që të jetë më e vogël se 2000 cm katror.

(b) Një furrik.

(c) Shtresë të mjaftueshme në mënyrë që çukitja dhe zhgërryerja të bëhen të mundura.

(d) Tela të përshtatshme për të qëndruar pulat (15 cm për çdo pulë).

2. Gjatësia e lugut të ushqimit të jetë së paku 12 cm shumëzuar me numrin e pulave pjellëse në kafaz që mund të përdoret pa kufizim.
3. Çdo kafaz të ketë sistem pirjeje në përputhje me madhësinë e grupit, kur ka pirëse automatike ato duhet të vendosen që çdo dy prej tyre të jetë e arritshme për çdo pulë.
4. Për të lehtësuar, kontrollin, instalimin dhe zbrazen e kafazeve ndërmjet kafazeve duhet të jetë një rresht 90 cm i gjerë dhe një hapësirë ndërmjet dyshemesë dhe fundit të kafazeve prej 35cm.
5. Kafazët duhet të përshtaten me ndarje që përdoret për shkurtimin e thonjve.

KAPITULLI VIII

Kushtet përfundimtare

Neni 16

Kushte të tjera shtesë

1. Të gjitha pulat duhet të inspektohen nga pronarët ose personi përgjegjës të paktën një herë në ditë.
2. Të minimizohen tingujt, të shmangen zhurmat e papritura ose konstante. Ventilatorët dhe makineritë e të ushqyerit si dhe pajisjet e tjera duhet të ndërtohen, vendosen, të funksionojnë dhe të mirëmbahen në mënyrë të tillë që ato të shkaktojnë sa më pak zhurmë.
3. Të gjitha ndërtesat duhet të jenë të pajisura me ndriçimin e nevojshëm në mënyrë që pulat të shikojnë njëra tjetrën si dhe të shikohen lehtë gjatë kontrollit. Në rast se ka ndriçim natyror, ky ndriçim të depërtojë kënaqshëm në të gjitha ambientet. Regjimi i ndriçimit duhet të jetë i tillë që të parandalojë problemet shëndetësore dhe të sjelljes. Ky ndriçim duhet të ndjekë ritmin 24 orësh shoqëruar me periudha errësire (1/3 e ditës në errësirë) që të parandalohen çrregullimet e syve dhe imunodepresionit.
4. Të gjitha pjesët e ndërtesës, pajisjet dhe mjetet të cilat bien në kontakt me pulat, të pastrohen me kujdes dhe të dezinfektohen rregullisht. Para futjes së një tufe të re, tufa ekzistuese duhet të largohet tërësisht d.m.th të boshatiset pularia. Kur kafazet janë të zënë, sipërfaqja dhe pajisjet duhet të mbahen të pastra. Pulat e ngordhura dhe glaset të hiqen sa më shpesh të jetë e mundur.
5. Kafazët duhet të jenë të tillë që të mos lejojnë që pulat të dalin jashtë prej tyre.

6. Dy ose më tepër rreshta kafazesh duhet të jenë të pajisur në mënyrë të tillë që të bëjnë të mundur inspektimin e të gjitha rreshtave pa vështirësi dhe të lehtësojnë largimin e pulave.

7. Projektimi dhe dimensionet e derës së kafazit duhet të jenë të tilla që të bëjnë të mundur largimin e pulës pa e dëmtuar atë dhe pa i shkaktuar dhimbje.

8. Janë të ndaluara të gjitha gjymtimet. Në mënyrë që të parandalohet kanibalizmi dhe pickimi i pulave duhet bërë prerja e sqepit nga një staf i kualifikuar jo më shumë se 10 ditë pas çeljes, për zogjtë që synohet të mbahen për vezë.

Neni 17 **Zbatimi**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Drejtoria e Politikave të Prodhimit dhe Tregjeve Bujqësore dhe Inspektorët e Zooteknisë në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në qarqe.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Jemin GJANA

